



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 32 prot

Dh. 29/06/2022



VENDIM

Nr. 25, datë 22.06.2022

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR PËRDORIM  
BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR”,  
SUBJEKTI “KOLA”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllim ambalazhimi, subjektit “KOLA”, me vendndodhje Qelëz, Pukë sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor, koordinatat KRGJSH

- X=496873
- Y=4664070
- Z=1441 m

Sasia e ujit që do të përdoret  $Q=0.336$  l/s  
Prurja mesatare vjetore:  $Q=1.552$  l/s  
Burimi ujqor "Shkalla e Fierës"

3. Ndërtimi i zonës sanitare do të bëhet sipas afatit 3 muaj nga data 01.05.2022, kohë të cilën nuk parashikohet prezencë bore, kohë e vendosur në kontratën e porosisë "Kontratës e sipërmarrjes" me subjektin "ERI" sh.p.k, në të kundërt pushohet fuqia juridike e vendimit.
4. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

